



**BASHKIA E TIRANËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

**Nr. 35, datë 3.09.2015**

**për**

**“KALIMIN E DIGËS SË LIQENIT ARTIFICIAL TË TIRANËS NË ADMINISTRIM  
TË SHOQËRISË UJËSELLËS KANALIZIME TIRANË SH.A”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 8 pika 1/II shkronja “a” dhe “c”, nenit 32 shkronja “e”, nenit 33 pika 4 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 për “Transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 281, datë 09.05.2007, “Për kalimin e Digës së Liqenit Artificial të Tiranës në pronësi të Bashkisë së Tiranës”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak,

**VENDOSI:**

1. Kalimin e Digës së Liqenit Artificial të Tiranës dhe veprave të tjera përbërëse të saj sipas planimetrisë bashkëlidhur këtij vendimi, në administrim të “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a .
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës për ndjekjen e mëtejshme të procedurave ligjore në lidhje me këtë pronë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Menaxhimit të Shërbimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse në Bashkinë e Tiranës dhe “Ujësjiellës Kanalizime Tiranë” sh.a.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

**Kryetari**

**ALDRIN DALIPI**